



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1372/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës se Kosovës- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli ne Prishtinë, kundër debitorit “Horeca L.L.C” me numër unik identifikues 810844515 me seli ne Prishtinë, përfaqësuar nga L.T. avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles e se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2191/22 dt.29.05.2023, me datën 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Horeca L.L.C” me numër unik identifikues 810844515 me seli ne Prishtinë, i ushtruar përmes përfaqësuesit te autorizuar nga L.T. avokat nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2191/22 dt.29.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles e se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2191/22 dt.29.05.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Horeca L.L.C” me numër unik identifikues 810844515 me seli ne Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.487/22 dt.12.08.2022 i Përmbartuesit Privat Flamur S.Boga për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë ndërsa urdhrin përmbartimor te përmbartuesit privat e lë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës dhe konstatimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta ndryshoj, urdhri përmbartimor te shfuqizohet dhe te obligohet kreditori te paguaj shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, me datën 12.08.2022, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit “Horeca L.L.C” me numër unik identifikues 810844515 me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përbarimor - Vendimit nr.12-108/20/B dt.20.07/2021 i lëshuar nga Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Përbaruesi Privat Flamur S.Bogaj në Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.487/22 dt.12.08.2022, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkimore, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,000.00 euro, në afat prej 7 ditësh si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 29.08.2022, duke theksuar se vendimi nuk është titull ekzekutiv, nuk përmban tipare të përbarueshmërisë sepse nuk përshkon gjendjen faktike. Inspektorati i punës nuk është organ i cili do të vendos lidhur me çështjen e ndërprerjes së marrëdhënies së punës apo pagesën e pagës. Dokumenti përbarimor nuk është i ekzekutueshëm, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhri përbarimor të shfuqizohet dhe të obligohet kreditori të paguaj shpenzimet e procedurës.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 06.09.2022, kreditori ka parashtruar përgjigje, duke kundërshtuar thëniet në prapësimin e debitorit, vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrative nuk e ndal ekzekutimin e vendimit. Propozon që gjykata të refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2191/22, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka konstatuar se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi është konform dispozitave ligjore nga neni 22 par.1 nenpar.1.2 të LPP, neni 27 par.1, neni 36 par.1 dhe 2 të LPP, ndërsa pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim përkitazi kompetencës së Inspektoratit dhe vërtetimi të gjendjes faktike ka konsideruar se nuk i nënshtrohen kompetencës së kësaj procedure sepse bazuar në parimin e rigorozitetit formal në këtë procedurë ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, andaj këto pretendime të debitorit i ka vlerësuar si të pabazuara dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përbarimor, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me

rastin e vendosjes. Edhe kjo gjykatë vlerëson se Vendimi nr.12-108/20/B dt.20.07.2021 i lëshuar nga Inspektorati i Punës ne Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe nenin 27 paragraf 1 i LPP, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me këtë dispozitë të LPP. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 04.03.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim. Ky dokument i plotëson të gjitha kushtet ligjore për tu përmbaruar edhe konform nenit 36 paragraf 1 të LPP - së, i cili parasheh që *“ Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se *“ Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe i përshtatshëm për ekzekutim, arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore, nën parimin e rigozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPP lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1372/23, me datë 15.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova